

DASHURIA E PASHMANGSHME E KRYEMINISTRIT

tetor 2019

10 ARSYE MBRAPA ROMANCËS SË KRYEMINISTRIT DHE PROCESIT
INTEGRUES

DASHURIA E PASHMANGSHME E KRYEMINISTRIT

10 ARSYE MBRAPA ROMANCËS SË KRYEMINISTRIT DHE PROCESIT
INTEGRUES

Tetor 2019, Prishtinë

Titulli i botimit:

DASHURIA E PASHMANGSHME E KRYEMINISTRIT: 10 arsye mbrapa romancës së Kryeministrit dhe procesit integrues

Botuar nga:

Botuar nga Instituti i Kosovës për Politikë Evropiane

Vendi dhe data e botimit:

Prishtinë, 2019

(faqe qëllimisht e lënë zbrazët)

TABELA E PËRMBAJTJES

Hyrja	6
Përmbledhja ekzekutive	7
Rëndësia e procesit integrimit	11
Vendimmarrja efektive	12
Vizibiliteti i procesi integrues	13
Llogaridhënia	14
Koordinim më eficient	15
Reformat e brendshme	17
Fqinjësia e mirë dhe procesi integrues	18
Kredibiliteti i fondeve të BE-së	19
Krijimi i qendrës qeveritare	21
Fuqizim administrativ	24

HYRJA

Në jetët tona ballafaqohemi me dy lloj dashurish: ato që duken si dashuri të përjetshme, dhe ato që janë të tilla.

Në kategorinë e parë bien ato dashuritë që karakterizojnë pjesën e parë të jetës së njeriut. Rënie për herë të parë në dashuri. Ndoshta edhe për të dytën, por pse jo edhe për të tretën dhe të katërtën herë. Eventualisht e kuptojmë se këto ishin dashuri shumë të e bukura, por në fund fare ishin të përkohshme.

Në kategorinë e dytë bien dashuritë që mbesin për tërë jetën. Dashuria për familjen, prindërit, fëmijët, disa miq të përzgjedhur, e kështu me radhë. Le ti quajmë këto të fundit dashuri të pashmangshme.

Në studimin tonë të radhës argumentojmë se marrëdhënia e Kryeministrit me procesin integruar bie pikërisht në këtë kategorinë e dytë – të dashurive të pashmangshme.

Këtë studim nuk e kemi pasur në planin tonë vjetor. Iniciativa për këtë studim u vu në lëvizje pas mbajtjes së zgjedhjeve

të parakohshme dhe nisjes së diskutimit për formimin e qeverisë së re.

Në diskursin publik u shfaq vullneti politik për zvogëlimin e numrit të ministrive, dhe në këtë kontekst është paraqitur ideja e bashkimit të Ministrisë së Integritimit Evropian me Ministrinë e Punëve të Jashtme.

Duke qenë se misioni i organizatës sonë është formulimi i alternativave të politikave publike, ky studim ishte i pashmangshëm.

Përderisa zvogëlimin e numrit e ministrive e mirëpresim me duar të hapura dhe entuziazëm të papërmbajtur, duhet të nënvizojmë se ndarja e procesit integruar nga Kryeministri do jetë gabim strategjik i cili do të krijojë parakushte për ngadalësim të reformave evropiane.

Në këtë drejtim, këtu shtjellojmë 10 arsye përse me mbylljen e Ministrisë së Integritimit Evropian procesi integruar duhet të bartet nën përgjegjësinë e “Kryereformatorit”, apo Kryeministrit të Republikës së Kosovës.

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Bazuar në përvojën e vendeve të rajonit, janë tre modele të organizimit të përgjegjësisë institucionale për koordinimin e procesit të integrimit evropian:

- Sekretariat/Zyrë/Agjenci në kuadër të Zyrës së Kryeministrit, dhe nën përgjegjësinë e Zëvendëskryeministrit përgjegjës për Integrim (Maqedoni, Bosnje);

- Ministria e Integrimit Evropian (Kosovë, Serbi);

- Ministria për Punë të Jashtme dhe Integrim Evropian (Mali i Zi, Shqipëri).

Duke marr për bazë përvojën e vendeve të rajonit, si dhe specifikat e procesit integruar, në këtë studim formulojmë 10 arsye përse modeli më i mirë i drejtimit të procesit integruar është nën autoritetin e Kryeministrit.

1. RËNDËSIA E PROCESIT INTEGRIMIT

Procesi i integrimit evropian nuk është thjesht një nga proceset. Ai është

procesi më i rëndësishëm shtetëror dhe përcaktim strategjik i shoqërisë sonë. 90% e qytetarëve të Republikës së Kosovës mendojnë se anëtarësimi në BE është gjë e mirë (RCC, Balkan Barometer, 2017). Duke qenë kështu, asnjë autoritet më i ultë se Kryeministri nuk mund të bartë këtë peshë shtetërore.

2. VENDIMARRJA EFEKTIVE

Në procesin integruar nuk ka vendime të lehta të cilat janë në juridiksionin e një ministrie. Vendimet në procesin integruar kërkojnë marrjen e vendimeve të vështira për shoqërinë të cilat mund t'i marrë vetëm Kryeministri.

Rrjedhimisht, çfarëdo arkitekturë institucionale e procesit integruar duhet të jetë e strukturuar në atë formë që mundëson përfshirjen dhe vendimmarrjen e drejtpërdrejtë të Kryeministrit në procesin integruar.

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

3. VIZIBILITETI I PROCESI INTEGRUES

Është esenciale që Kryeministri, si titullar i Qeverisë, të marrë përgjegjësinë dhe udhëheqjen në komunikimin e procesit integrues. Kjo e vendosë Kryeministrin në epiqendër të komunikimit të procesit integrues me akterët shoqërorë.

4. LLOGARIDHËNIA

Kryeministri emëron, Kryeministri shkarkon. Kjo fjali përmbledh esencën e argumentit të llogaridhënies në procesin më të rëndësishëm reformues, siç është procesi integrues. Arkitektura institucionale për procesin integrues duhet të jetë e dizajnuar ashtu që në epiqendër të saj të jetë kërkesa për ndërmarrjen e reformave dhe informimi i drejtë i Kryeministrit për të kërkuar llogaridhënie.

5. KOORDINIM MË EFIÇIENT

Brenda Qeverisë ka shumë shefa, por është një person vendimet e cilit janë të pakthyeshme dhe të anegociueshme – vendimet e Kryeministrit.

Prandaj, vetëm një autoritet superior, siç është Kryeministri, mund të ofrojë peshën dhe autoritetin e nevojshëm politik për të siguruar koordinimin efektiv të agjendës evropiane, si brenda ashtu edhe jashtë Qeverisë.

6. REFORMAT E BRENDSHME

Suksesi i procesit integrues matet me numrin e rasteve të suksesshme në luftën kundër korrupsionit të nivelit të lartë në Prishtinë, numrin e inspektimeve të vendeve të punës në Pejë, numrin e impianteve të ujit të ndërtuara në Mitrovicë, apo numrin e fëmijëve të regjistruar në arsimin parashkollor në Prizren. Rrjedhimisht, duhet kuptuar saktë procesin integrues si proces i reformave të brendshme të cilat bëjnë të mundur një jetë më të mirë për qytetarët e Kosovës, jo për qytetarët e Francës apo të Gjermanisë. Prandaj, qasja thjeshtëzuese dhe e painformuar sipas së cilës procesi i integritit ka ndonjë të përbashkët me Ministrinë e Punëve të Jashtme është sa e gabueshme po aq edhe fatale për procesin integrues.

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

7. FQINJËSIA E MIRË DHE PROCESI INTEGRUES

Duke njohur faktin se viteve të fundit jemi dëshmitarë të ndërlidhjes gjithnjë e më të ngushtë ndërmjet procesit integrues dhe fqinjësisë së mirë në Ballkanin Perëndimor, Kryeministri do të jetë në situatë ideale që të jetë pikë ndërlidhëse ndërmjet këtyre dy proceseve, duke evituar kështu dikotominë mes tyre.

8. KREDIBILITETI I FONDEVE TË BE-SË

Këto nuk janë vetëm para, por janë çështje e kredibilitetit të shtetit të Kosovës. Viteve të fundit kemi qenë dëshmitarë se Kosova ka humbur fonde të BE-së për shkak mospërbushjes së obligimeve nga ana e institucioneve. Kjo është e patolerueshme. Duke njohur peshën politike të fondeve të BE-së, si dhe duke njohur pengesat të cilat mund të shfaqen në absorbimin e tyre, dhe të cilat mund të tejkalohen vetëm më autoritetin e Kryeministrit, kjo e vë Kryeministrin pozicion të pazëvendësueshëm në marrjen e përgjegjësisë për fondet e BE-së.

9. KRIJIMI I QENDRËS QEVERTITARE

Qeveria është një institucion jashtëzakonisht kompleks dhe shumëdimensional. Ekzekutimi i mandatit të Kryeministrit është ndërmarrje shumë komplekse politike dhe teknike. Çdo ditë Kryeministri vërshohet nga dhjetëra çështje urgjente, dhe jo-urgjente, që konsumojnë vëmendjen, kohën dhe kapitalin e tij politik. Procesi integrues imponon bashkimin e strukturës integruese me qendrën e Qeverisë në mënyrë që të sigurohet unifikim i plotë i procesit integrues me politikat ditore të saj, duke fokusuar kështu vëmendjen e Kryeministrit në çështjet më të rëndësishme dhe më urgjente. Çdo largim i këtyre dy strukturave mbart me vete kosto për procesin integrues.

10. FUQIZIM ADMINISTRATIV

Bashkimi Evropian, Gjermania, Luksemburgu dhe Norvegjia kanë investuar deri më sot 43.7 milionë EURO në avancimin e stafit përgjegjës për integrim evropian.

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Fuqizimi i stafit të angazhuar në fushën e integritetit evropian, nën ombrellën e strukturës më të lartë Qeveritare – Kryeministrit, do të mundësojë atyre që të kontribuojnë në përshejtim e ndërmarrjes së reformave evropiane, duke marrë për bazë peshën e autoritetit që do të ushtrojnë nën autoritetin suprem të Qeverisë.

DASHURIA E PASHMANGSHME E KRYEMINISTRIT: 10 ARSYE MBRAPA ROMANCËS SË KRYEMINISTRIT DHE PROCESIT INTEGRUES

1. RËNDËSIA E PROCESIT INTEGRIMIT

Procesi i integrimit evropian nuk është thjesht një nga proceset. Ai është procesi më i rëndësishëm shtetëror dhe përcaktim strategjik i shoqërisë sonë. 90% e qytetarëve të Republikës së Kosovës mendojnë se anëtarësimi në BE është gjë e mirë (RCC, Balkan Barometer, 2017).

Si i tillë, procesi integruës kërkon vullnetin, vëmendjen dhe angazhimin personal të Kryeministrit të Republikës së Kosovës. Krijimi i çfarëdo distance dhe hapësire në mes të Kryeministrit dhe procesit integruës do të krijojë parakushte për ngadalësim të procesit integruës, dhe rrjedhimisht do të këtë pasoja në dinamikën e këtij procesi.

Për më tepër, marrja përsipër e përgjegjësisë personale nga ana e Kryeministrit për procesin integruës do t'i dërgonte mesazh të qartë për Bashkimit Evropian se Qeveria e kupton përnjëmend se procesi integrimit nuk ka të bëjë asgjë me punë të jashtme, por se i tëri ka të bëjë me reforma të brendshme.

”Krijimi i çfarëdo distance dhe hapësire në mes të Kryeministrit dhe procesit integruës do të krijojë parakushte për ngadalësim të procesit integruës, dhe rrjedhimisht do të këtë pasoja në dinamikën e këtij procesi.”

”Marrja përsipër e përgjegjësisë personale nga ana e Kryeministrit për procesin integruës do t'i dërgonte mesazh të qartë për Bashkimit Evropian se Qeveria e kupton përnjëmend se procesi integrimit nuk ka të bëjë asgjë me punë të jashtme, por se i tëri ka të bëjë me reforma të brendshme.”

DASHURIA E PASHMANGSHME E KRYEMINISTRIT: 10 ARSYE MBRAPA ROMANCËS SË KRYEMINISTRIT DHE PROCESIT INTEGRUES

2. VENDIMARRJA EFEKTIVE

Procesi i integritit evropian është shtytësi kryesor i demokratizimit të shoqërisë dhe ndryshimit rrënjësor të sistemit politik, ekonomik dhe social. Si i tillë, ai ka stimuluar ndryshime të paprecedent në vendet ish-komuniste drejt shndërrimit të tyre në demokraci liberale me ekonomi tregu të qëndrueshme e prosperuese, dhe vendosjen e sundimit të ligjit në epiqendër të këtij transformimi.

Si i tillë, procesi integrues kërkon vendimmarrje efektive e cila, për nga vet natyra e saj, mund ekzekutohet vetëm nga Kryeministri. Në procesin integrues nuk ka vendime të lehta të cilat janë nën juridiksionin e një ministri. Vendimet e procesit integrues kërkojnë marrjen e vendimeve të vështira për shoqërinë të cilat mund t'i marrë vetëm Kryeministri.

Rrjedhimisht, çfarëdo arkitekturë institucionale e procesit integrues duhet të jetë e strukturuar në atë formë që të mundësojë përfshirjen dhe vendimmarrjen e drejtpërdrejtë të Kryeministrit në procesin integrues.

”Në procesin integrues nuk ka vendime të lehta të cilat janë nën juridiksionin e një ministri. Vendimet e procesit integrues kërkojnë marrjen e vendimeve të vështira për shoqërinë të cilat mund t'i marrë vetëm Kryeministri.”

DASHURIA E PASHMANGSHME E KRYEMINISTRIT: 10 ARSYE MBRAPA ROMANCËS SË KRYEMINISTRIT DHE PROCESIT INTEGRUES

3. VIZIBILITETI I PROCESIT INTEGRUES

Reformat në procesin integrues janë komplekse dhe të dhimbshme për shoqërinë. Ato kërkojnë ndryshimin e status quo-së dhe sakrifica të sotme për qëllim të krijimit të të një të ardhmeje më të mirë.

Në këtë drejtim, është e rëndësishme që Qeveria të sigurojë komunikimin e vazhdueshëm të reformave të nevojshme në rrugën integruese, duke shpjeguar qartë kostot dhe përfitimet e ndërmarrjes së reformave përkatëse. Kjo nuk është e lehtë, dhe kërkon përfshirjen e të gjithë akterëve të shoqërisë, siç janë shoqëria civile, mediat, komuniteti i biznesit, akademia, etj.

Në këtë drejtim, është esenciale që Kryeministri, si titullar i Qeverisë, të marrë përgjegjësinë dhe udhëheqjen në komunikimin e procesit integrues. Kjo do të vendosë Kryeministrin në epiqendër të komunikimit të procesit integrues me qytetarët. Rrjedhimisht, një gjë e tillë do t'i ofrojë procesit integrues vizibilitetin e nevojshëm për të krijuar një mjedis i cili do të mbështesë ndërmarrjen e reformave para nesh.

”Është esenciale që Kryeministri, si titullar i Qeverisë, të marrë përgjegjësinë dhe udhëheqjen në komunikimin e procesit integrues.”

DASHURIA E PASHMANGSHME E KRYEMINISTRIT: 10 ARSYE MBRAPA ROMANCËS SË KRYEMINISTRIT DHE PROCESIT INTEGRUES

4. LLOGARIDHËNIA

Kryeministri emëron, Kryeministri shkarkon. Kjo fjali përmbledh esencën e argumentit të llogaridhënies në procesin më të rëndësishëm reformues: procesit integrues.

Të gjithë i duan reformat, por pak kush është gati të sakrifikojë për to. Mungesa e entuziazmit për reformat bazohet në disa faktorë: (1) Reformat shpesh bien në kundërshtim me interesat e grupeve të interesit; (2) Reformat prishin status quo-në; (3) Reformat janë të kushtueshme; e kështu me radhë.

Sidoqoftë, është një person i cili para sovranit merr përgjegjësinë përfundimtare për krijimin e një të nesërme më të mirë – Kryeministri.

Rrjedhimisht, arkitektura institucionale për procesin integrues duhet të jetë e dizajnuar ashtu që në epiqendër të saj të jetë kërkesa për ndërmarrjen e reformave dhe informimi i drejtë i Kryeministrit për të kërkuar llogaridhënie.

”Arkitektura institucionale për procesin integrues duhet të jetë e dizajnuar ashtu që në epiqendër të saj të jetë kërkesa për ndërmarrjen e reformave dhe informimi i drejtë i Kryeministrit për të kërkuar llogaridhënie.”

Kjo imponon që Kryeministri të ketë në kohë reale informatën për statusin e reformave në rrugën integruese dhe të ofrohen opsionet për të evituar bllokimin e tyre duke ftuar çdo person përgjegjës për llogaridhënie. Në këtë drejtim, duhet nënvizuar qartë se asnjë autoritet tjetër brenda ekzekutivit nuk ka për mandat kërkimin e llogaridhënies absolute ashtu siç e ka Kryeministri.

DASHURIA E PASHMANGSHME E KRYEMINISTRIT: 10 ARSYE MBRAPA ROMANCËS SË KRYEMINISTRIT DHE PROCESIT INTEGRUES

5. KOORDINIM MË EFIÇIENT

Koordinimi i agjendës evropiane është çështje horizontale, dhe ka specifikat e saj jo vetëm në sferën e saj të natyrës koordinuese, por çfarë është shumë e rëndësishëm të kuptohet, është se ka rolin edhe të formësimit të politikave reformuese përgjatë gjithë sektorëve prioritare të agjendës evropiane, siç është sundimi i ligjit, reformat ekonomike dhe reforma e administratës publike.

Brenda Qeverisë ka shumë shefa. Për shembull, brenda Ministrisë së Drejtësisë, autoritet është Ministri si titullar i institucionit. Ai përcakton drejtimin e institucionit dhe udhëzimet e tij kanë peshë të madhe. Sidoqoftë, për disa gjëra, shefi i Ministrisë së Drejtësisë është p.sh. Ministri Financave, pasi që ka mandat të anulojë apo fuqizojë vendimet e Ministrisë së Drejtësisë sa i përket aspektit buxhetor.

Por, ekziston një person vendimet e cilit janë të pakthyeshme dhe të panegociueshme – vendimet e Kryeministrit.

”Çfarë është shumë e rëndësishëm të kuptohet, është se procesi i integritimit evropian nuk është vetëm rol koordinues, por ka rol të formësimit të politikave reformuese përgjatë gjithë sektorëve prioritare të agjendës evropiane, siç është sundimi i ligjit, reformat ekonomike dhe reforma e administratës publike.”

DASHURIA E PASHMANGSHME E KRYEMINISTRIT: 10 ARSYE MBRAPA ROMANCËS SË KRYEMINISTRIT DHE PROCESIT INTEGRUES

Në Qeveri, urdhrat ndahen në urdhra dhe URDHRA. Kategorinë e parë edhe mund ta injorosh, por injorimi i urdhrave të Kryeministrit ka pasoja fatale.

Në këtë drejtim, kërkesat e procesit integrues, për nga vet natyra e tyre, kërkojnë përpikëri në zbatimin e tyre, duke siguruar se e gjithë administrata respekton në detaje kërkesat që burojnë nga agjenda evropiane, duke u dëshmuar kështu institucioneve të BE-së se reformat janë ndërmarrë dhe rezultatet janë të faktueshme.

Kjo kërkon koordinim efektiv jo vetëm të ministrive të linjës, por të të gjitha institucioneve shtetërore, përfshirë degët e pavarura, siç janë legjislativi dhe sistemi prokurorial e ai gjyqësor.

Prandaj, vetëm një autoritet superior siç është Kryeministri mund të ofrojë peshën dhe autoritetin e nevojshëm politik për të siguruar koordinimin efektiv të agjendës evropiane, si brenda ashtu edhe jashtë Qeverisë.

”Vetëm një autoritet superior siç është Kryeministri mund të ofrojë peshën dhe autoritetin e nevojshëm politik për të siguruar koordinimin efektiv të agjendës evropiane, si brenda ashtu edhe jashtë Qeverisë.”

DASHURIA E PASHMANGSHME E KRYEMINISTRIT: 10 ARSYE MBRAPA ROMANCËS SË KRYEMINISTRIT DHE PROCESIT INTEGRUES

6. REFORMAT E BRENDSHME

Suksesi i procesit integrues matet me numrin e rasteve të suksesshme në luftë kundër korrupsionit të nivelit të lartë në Prishtinë, numrin e inspektimeve të vendeve të punës në Pejë, numrin e impianteve të ujit të ndërtuara në Mitrovicë, apo numrin e fëmijëve të regjistruar në arsimin parashkollor në Prizren.

Rrjedhimisht, duhet kuptuar saktë procesin integrues si proces reformash të brendshme të cilat bëjnë të mundur një jetë më të mirë për qytetarët e Kosovës, jo për qytetarët e Francës apo të Gjermanisë. Prandaj, qasja thjeshtëzuese dhe e painformuar sipas së cilës procesi i integrimit ka ndonjë të përbashkët me Ministrinë e Punëve të Jashtme është po aq e gabueshme sa edhe fatale për procesin integrues.

Në këtë drejtim, Kryeministri, në rolin e tij si “Kryereformator”, është adresa e vetme për të bartur përgjegjësinë e procesit integrues si proces i reformave të brendshme.

”Qasja thjeshtëzuese dhe e painformuar sipas së cilës procesi i integrimit ka ndonjë të përbashkët me Ministrinë e Punëve të Jashtme është po aq e gabueshme sa edhe fatale për procesin integrues”

DASHURIA E PASHMANGSHME E KRYEMINISTRIT: 10 ARSYE MBRAPA ROMANCËS SË KRYEMINISTRIT DHE PROCESIT INTEGRUES

7. FQINJËSIA E MIRË DHE PROCESI INTEGRUES

Viteve të fundit jemi dëshmitarë të ndërlidhjes gjithnjë e më të ngishte ndërmjet procesit integrues dhe fqinjësisë së mirë në Ballkanin Perëndimor. Mesazhi nga Bashkimi Evropian është i qartë dhe i zëshëm: nuk do të importojmë probleme rajonale brenda BE-së. Të gjitha mosmarrëveshjet fqinjësore duhet të zgjidhen para anëtarësimit të Ballkanit në BE.

Një kërkesë e tillë ka filluar të marrë përmasa dhe efekte praktike. Në kuadër të negociatave të Serbisë për anëtarësim në BE, asaj i është vendosur brenda kapitullit 35 kushti që negociatat e anëtarësimit mund të pezullohen në rast të mungesës së vullnetit të Serbisë në kuadër të normalizimit të marrëdhëniet me Kosovën përmes një marrëveshjeje përfundimtare të detyrueshme. Nga ana tjetër, MSA ndërmjet Kosovës dhe BE-së përmban “nenin bërthamor”, sipas të cilit BE-ja ka të drejtë të pezullojë zbatimin e tërë marrëveshjes në rast të mungesës së vullnetit të Kosovës në kuadër të normalizimit të marrëdhënieve me Serbinë.

”Kryeministri do të jetë në situatë ideale që të jetë pikë ndërlidhëse ndërmjet dy proceseve të ndërlidhura ngushtë, procesit të normalizimit të marrëdhënieve dhe procesit të integritit evropian, duke evituar kështu dikotominë mes këtyre dy proceseve.”

Në përputhje me vendimin e Gjykatës Kushtetuese, Kryeministri është autoriteti i cili do të udhëheqë dialogun për normalizimin e marrëdhënieve me Serbinë. Në këtë drejtim, Kryeministri do të jetë në situatë ideale që të jetë pikë ndërlidhëse ndërmjet dy proceseve të ndërlidhura ngushtë, procesit të normalizimit të marrëdhënieve dhe procesit të integritit evropian, duke evituar kështu dikotominë mes këtyre dy proceseve.

DASHURIA E PASHMANGSHME E KRYEMINISTRIT: 10 ARSYE MBRAPA ROMANCËS SË KRYEMINISTRIT DHE PROCESIT INTEGRUES

8. KREDIBILITETI I FONDEVE TË BE-SË

Kosova, në periudhën që po e lëmë pas, ka përfituar 602 milionë EURO nga fondet e BE-së. Pritet që Kosova të përfitojë një shumë të përafërt të këtyre fondeve edhe për periudhën e re financiare të BE-së: 2021-2027.

Fondet e BE-së nuk janë vetëm çështje financiare. Ato janë çështje të kredibilitetit shtetëror. Kosova duhet t'ua dëshmojë institucioneve të BE-së dhe shteteve anëtare se vlerëson lart besimin politik dhe asistencën financiare që BE-ja ofron në mënyrë bujare.

Viteve të fundit kemi qenë dëshmitarë se Kosova ka humbur fonde të BE-së për shkak mospërbushjes së obligimeve nga ana e institucioneve. Kjo është e patolerueshme. Zhvillimet e këtilla nuk janë vetëm humbje financiare, por ato gjithashtu dëmtojnë rëndë kredibilitetin e Kosovës në rrugën e saj evropiane.

”Fondet e BE-së nuk janë vetëm çështje financiare. Ato janë çështje të kredibilitetit shtetëror.”

DASHURIA E PASHMANGSHME E KRYEMINISTRIT: 10 ARSYE MBRAPA ROMANCËS SË KRYEMINISTRIT DHE PROCESIT INTEGRUES

Nëse tatimpaguesit e BE-së ndajnë nga të hyrat e tyre mjete financiare për të kontribuar për jetë më të mirë për qytetarët e Kosovës, minimumi që institucionet e Kosovës duhet të sigurojnë është zbatimi i mirëfilltë i projekteve të financuara përmes këtyre mjeteve.

Gjithashtu duhet nënvizuar se në kuadër të procesit integrues Kosova ka mundësi të aplikojë për fonde madhore, siç janë Korniza Investuese e Ballkanit Perëndimor (WBIF).

WBIF financon projekte infrastrukturore që tejkalojnë qindra milionë euro (psh. Autostradën Prishtinë – Nish) dhe natyra e këtyre projekteve ka peshë të interesit nacional të cilin mund ta përfaqësojë vetëm Kryeministri. Rrjedhimisht, duke njohur peshën politike të fondeve të BE-së dhe pengesat të cilat mund të hasen në absorbimin e fondeve dhe të cilat mund të tejkalojnë vetëm me autoritetin e Kryeministrit, kjo e vë Kryeministrin në pozicion të pazëvendësueshëm në marrjen e përgjegjësisë për fondet e BE-së.

”Duke njohur peshën politike të fondeve të BE-së dhe pengesat të cilat mund të hasen në absorbimin e fondeve dhe të cilat mund të tejkalojnë vetëm me autoritetin e Kryeministrit, kjo e vë Kryeministrin në pozicion të pazëvendësueshëm në marrjen e përgjegjësisë për fondet e BE-së.”

DASHURIA E PASHMANGSHME E KRYEMINISTRIT: 10 ARSYE MBRAPA ROMANCËS SË KRYEMINISTRIT DHE PROCESIT INTEGRUES

9. KRIJIMI I QENDRËS QEVERTARE

Qeveria është një institucion jashtëzakonisht kompleks dhe shumëdimensional. Ekzekutimi i mandatit të Kryeministrit është ndërmarrje shumë komplekse politike dhe teknike. Çdo ditë, Kryeministri vërskohet nga dhjetëra çështje urgjente, dhe jo-urgjente, që konsumojnë vëmendjen, kohë dhe kapitalin e tij politik.

Në këtë drejtim, Kryeministri asistohet nga një numër të shërbimeve teknike në kuadër të Zyrës së Kryeministrit, siç janë: Sekretariati Koordinues i Qeverisë (SKQ): përgjegjës për koordinimin e punëve të përditshme të Qeverisë, Zyra për Planifikim Strategjik (ZPS): përgjegjëse për formësim të mendimit afatgjatë të Qeverisë; Zyra Ligjore e Kryeministrit (ZL): e cila duhet të sigurojë funksionimin ligjor të Qeverisë.

Në këtë drejtim, procesi integrues, për kah natyra e tij, kërkon bashkëpunim ditor dhe të afërt me funksionet e zyrave qendrore të Kryeministrit.

”Çdo ditë, Kryeministri vërskohet nga dhjetëra çështje urgjente, dhe jo-urgjente, që konsumojnë vëmendjen, kohën dhe kapitalin e tij politik.”

DASHURIA E PASHMANGSHME E KRYEMINISTRIT: 10 ARSYE MBRAPA ROMANCËS SË KRYEMINISTRIT DHE PROCESIT INTEGRUES

Me fjalë të tjera, SKQ duhet të sigurojë që obligimet e procesit integrues të jenë pjesë e planit të punës së Qeverisë dhe mbledhjeve të rregullta të saj, ZPS duhet të sigurojë që obligimet e procesit integrues të jenë pjesë e strategjisë afatgjatë të Qeverisë, ndërsa ZL duhet të sigurojë që aktet normative që miratohen nga Qeveria të jenë në përputhje me obligimet e procesit integrues dhe procesi i të gjitha reformave ligjore të harmonizohet me reformat e integritit evropian dhe të reflektojë ato, në tërësinë e tyre dhe në mënyrë të vazhdueshme deri në anëtarësimin e plotë në BE. Ndërlidhja e procesit të planifikimit të politikave duhet të ekzistojë në qendër të qeverisë. Plani i punës së Qeverisë, agjenda legislative, planifikimi strategjik, planifikimi i asistencës së donatoreve, planifikimi i procesit të integritit evropian duhet të ndërlidhen fuqishëm nën rolin udhëheqës dhe kryesor në qendër të Qeverisë – Kryeministrit.

Me fjalë të tjera, brenda Qeverisë, Kryeministri duhet të ketë vendimmarrje të drejtpërdrejtë përkitazi me procesin integrues, planifikimin afatgjatë,

”Ndërlidhja e procesit të planifikimit të politikave duhet të ekzistojë në qendër të qeverisë. Plani i punës së Qeverisë, agjenda legislative, planifikimi strategjik, planifikimi i asistencës së donatoreve, planifikimi i procesit të integritit evropian duhet të ndërlidhen fuqishëm nën rolin udhëheqës dhe kryesor në qendër të Qeverisë – Kryeministrit.”

DASHURIA E PASHMANGSHME E KRYEMINISTRIT: 10 ARSYE MBRAPA ROMANCËS SË KRYEMINISTRIT DHE PROCESIT INTEGRUES

agjendën legjislative dhe asistencën financiare ndërkombëtare. Çdo duplikim apo dikotomi në mes këtyre proceseve do të shkaktoj kosto politike, financiare dhe administrative në qeverisje, të cilat pashmangshëm do të shkaktojnë pasoja në dinamikën e procesit integrues.

Rrjedhimisht, delegimi i një pjesë kyçe të procesit kyç të orientimit strategjik siç është procesi i integritimit evropian, pashmangshëm do e komplikoj procesin vendimmarrës në këtë aspekt, do e fragmentoj procesin e planifikimit të politikave qendrore të Qeverisë, siç përmendem më lartë, dhe do e zbeh rolin e integritimit evropian që ka në proceset reformuese të shoqërisë. Prandaj, procesi integrues imponon bashkimin e strukturës integruese me qendrën e Qeverisë në mënyre që të sigurohet unifikim i plotë i procesit integrues me politikat ditore të Qeverisë, duke fokusuar vëmendjen e Kryeministrit në çështjet më të rëndësishme dhe më urgjente. Çdo largim i këtyre dy strukturave do të mbart kosto në procesin integrues.

”Procesi integrues imponon bashkimin e strukturës integruese me qendrën e Qeverisë në mënyre që të sigurohet unifikim i plotë i procesit integrues me politikat ditore të Qeverisë, duke fokusuar vëmendjen e Kryeministrit në çështjet më të rëndësishme dhe më urgjente. Çdo largim i këtyre dy strukturave do të mbart kosto në procesin integrues.”

DASHURIA E PASHMANGSHME E KRYEMINISTRIT: 10 ARSYE MBRAPA ROMANCËS SË KRYEMINISTRIT DHE PROCESIT INTEGRUES

10. FUQIZIM ADMINISTRATIV

Që nga viti 2004 struktura për integrim evropian është përkrahur në vazhdimësi nga BE-ja nëpërmjet “Skemës së Profesionistëve të Rinj” (e njohur në titullin origjinal si Young Cell Scheme, apo shkurtimisht YCS), përmes së cilës një numër të rinjsh janë dërguar për studime post-diplomike jashtë vendit në fusha të caktuara të nevojshme për procesin e integritit evropian dhe më pas janë punësuar si nëpunës civilë në administratën publike të Kosovës për një periudhë së paku 3-vjeçare. Deri më tani janë dërguar për studime 364 studentë nga 12 raunde (raundi i fundit kthehen për studime gjatë vitit 2020) dhe një numër i madh i tyre kanë punuar apo vazhdojnë të punojnë në Ministrinë e Integritit Evropian (aktualisht 37 përfitues të YCS).

Duke filluar nga viti 2004, vetëm për projektin YCS BE-ja ka dhënë rreth 15 milionë euro, kurse për raundet e fundit, 11 dhe 12, Kosova ka marrë pjesë me bashkëfinancim prej gjithsej 1 milionë euro. 3 raunde të ardhshme tashmë janë planifikuar, dhe pritet të mbështesin

”Duke filluar nga viti 2004, vetëm për projektin YCS BE-ja ka dhënë rreth 15 milionë euro, kurse për raundet e fundit, 11 dhe 12, Kosova ka marrë pjesë me bashkëfinancim prej gjithsej 1 milionë euro.”

DASHURIA E PASHMANGSHME E KRYEMINISTRIT: 10 ARSYE MBRAPA ROMANCËS SË KRYEMINISTRIT DHE PROCESIT INTEGRUES

studimet post-diplomike të afro 150 të rinjve, me një shumë totale prej 4.5 milionë eurosh nga BE-ja dhe 1.5 milionë nga Kosova. Përveç asistencës për projektin YCS, BE-ja deri më tani ka përkrahur stafin përgjegjës për procesin integrues me asistencë teknike me mbi 7 milionë euro dhe është planifikuar përkrahje e mëtutjeshme me së paku 1.2 milionë euro gjatë viteve të ardhshme. Qeveria gjermane ka dhënë mbi 8 milionë euro për të përkrahur procesin e integritit evropian dhe ka planifikuar edhe afro 3 milionë të tjera për periudhën e ardhshme 2020-2023.

Përveç këtyre, stafi përgjegjës për procesin integrues ka përfituar dhe përfiton asistencë të konsiderueshme nga donatorë të tjerë, sikurse Luksemburgu dhe Norvegjia (së bashku 3.5 milionë euro të planifikuara) dhe nga një numër projektsh nga partnerë të ndryshëm. Duhet nënvizuar se stafi i angazhuar në procesin e integritit evropian ka qenë lider për sa i përket integritetit të administratës publike, e siguruar përmes rekrutimit të nëpunësve civilë të saj nga skema YCS dhe nga ndihma e vazhdueshme e partnerëve të jashtëm.

”Qeveria gjermane ka dhënë mbi 8 milionë euro për të përkrahur procesin e integritit evropian dhe ka planifikuar edhe afro 3 milionë të tjera për periudhën e ardhshme 2020-2023.”

DASHURIA E PASHMANGSHME E KRYEMINISTRIT: 10 ARSYE MBRAPA ROMANCËS SË KRYEMINISTRIT DHE PROCESIT INTEGRUES

Kjo është e evidente posaçërisht në raportet kredibile të jashtme, sikurse ato të BE-së për progresin e vendit në procesin e integrimit evropian, sidomos në atë të vitit 2010 dhe në raportet e SIGMA-OECD për performancën e administratës publike në rajon. Për më tepër, projekti YCS është vlerësuar si projekt lider në rajon për reformimin e administratës publike nga vetë BE-ja në Strategjinë e Zgjerimit të vitit 2014.

Në këtë drejtim, fuqizimi i stafit të angazhuar në fushën e integrimit evropian, nën ombrellën e strukturës më të lartë Qeveritare – Kryeministrit, do të mundësojë atyre që të kontribuojnë në përshejtim e ndërmarrjes së reformave evropiane, duke marrë për bazë peshën e autoriteti që do të ushtrojnë nën autoritetin suprem të Qeverisë.

”Fuqizimi i stafit të angazhuar në fushën e integrimit evropian, nën ombrellën e strukturës më të lartë Qeveritare – Kryeministrit, do të mundësojë atyre që të kontribuojnë në përshejtim e ndërmarrjes së reformave evropiane, duke marrë për bazë peshën e autoriteti që do të ushtrojnë nën autoritetin suprem të Qeverisë.”

(faqe qëllimisht e lënë zbrazët)

INSTITUTI I KOSOVËS PËR POLITIKAT EVROPIANE, 2019.
KONTRIBUT PUBLIK. DREJTAT NUK JANË TË MBROJTURA :)